



2395

14/1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORATI SHTETËROR I PUNËS DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE
DREJTORIA E INSPEKTIMIT TË PUNËS

Nr. 295/1 Prot.

Tiranë, më 14/02/2024

Lënda: Dërgojmë informacion

Z. Dorian Matlija
Adresa elektronike: qendra.respublica@gmail.com

I nderuar z. Matlija,

Në lidhje me kërkesën tuaj ju informojmë, sipas kronologjisë së pyetjeve, si më poshtë :

A ka patur denoncime për vitin 2023, nga gra në marrëdhënie pune në raport me të drejtat në punë?

Për periudhën Janar- Dhjetor 2023 pranë Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, janë depozituar 800 ankesa e kërkesa për sqarime ligjore, konkretisht :

- 82.5% janë ankesa të punëmarrësve në raport me pretendime të tyre për shkelje të të drejtave në punë.
- 17.5% janë kërkesa për sqarime ligjore.

Nga 82.5% e ankesave të depozituar 42.5% e ankesave janë denoncime të kryera nga punëmarrëse gra.

Në përgjigjen e mëposhtme përfshihen pyetjet 2 dhe 3. Pra: Sa ka qënë numri i këtyre raporteve apo shkeljeve në vendin e punës? dhe Cilat janë llojet e shkeljeve që janë denoncuar?

Pretendimet kryesore të denoncimeve lidhen me mosrespektimin e dispozitave ligjore të mospagesës së pagës sipas përcaktimit ligjor në kohën dhe masën e duhur, si dhe pretendime të tjera si mospagesa për orë shtesë të kryera, për punë të kryer në festa zyrtare , ndërprerje marrëdhënie pune etj (sqarojmë se një ankesë mund të ketë dy ose më shumë pretendime). Konkretisht sipas tipologjisë i gjeni si më poshtë:

- 15.5% e ankesave janë për cenim të marrëdhënieve të punës përfshihen, mospagesë për punë të kryer në ditët e festave zyrtare, për punë të kryer në orë shtesë, dhënie page jo nëpërmjet sistemit bankar, ku 68.2% janë zgjidhur plotësisht ose pjesërisht
- 33% e ankesave janë për mos pagesa të pagave të prapambetura, ku 79.1% janë zgjidhur.
- 14.5% e ankesave janë për mos pagesa të kontributeve të sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore, ku 73.1% janë zgjidhur.
- 4% e ankesave janë për mos pagesa të raporteve mjekësore, ku 63.6% janë zgjidhur.
- 20.5% e ankesave janë për ndërprerje të marrëdhënieve të punës, ku 70.7% janë zgjidhur.
- 1.4% e ankesave janë për mosnjohim aksidenti në punë, ku 75% janë zgjidhur.
- 2.3% e ankesave janë për punësim të paligjshëm, ku 80% janë zgjidhur.
- 8.8% e ankesave janë për arsye të tjera ku përfshihen mospajisje me librezë pune apo mosplotësim i saktë në të të arsyes së largimi etj, ku 57% janë zgjidhur.

Në total 72 % e denoncimeve të punëmarrësve gra rezultojnë të jenë zgjidhur plotësisht ose pjesërisht.

Disa nga shkeljet e konstatuara më shpesh gjatë kontrolleve të ushtruar në subjekte janë si më poshtë:

- Ligji 7961 date 12.07.1995 "Kodi i punës RSII-së i ndryshuar) Neni 110 /1.
- Ligji 9136 date 11.09.2003 Për mbledhjen e detyrueshme të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore (i ndryshuar) neni 6 Pika 1.
- Ligji 7961 date 12.07.1995 "Kodi i Punës RSH-së" (i ndryshuar) Neni 124 / 2
- Ligji 7961 dt 12.07.1995 "Kodi i Punës R.SII-së" (i ndryshuar) neni 94 pika 5.
- Ligji 10237 dt 18.02.2010 "Ligji për sigurinë dhe shëndetin në punë" (i ndryshuar) neni 14/1.
- Ligji 7961 dt 12.07.1995 "Kodi i Punës R.SII-së" (i ndryshuar) neni 144 /2.
- 7961 dt 12.07.1995 "Kodi i Punës R.SII-së" (i ndryshuar) neni 147 / 1.
- Ligji 10237 date 18.02.2010 "Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë" (i ndryshuar) neni 10 germa b,
- Ligji 10237 date 18.02.2010 "Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë" (i ndryshuar) neni 23/ 1.
- Ligji 7961 date 12.07.1995 "Kodi i punës RSH-së" (i ndryshuar) Neni 21/1.

Cilat janë masat e marra nga Inspektoriati në lidhje me rastet e raportuara?

Gjatë kontrolleve të ushtruara për shkak të ankesave në subjekte na rezultojnë jo në pak raste shkelje të dispozitave ligjore të pasqyruara më sipër. Nga ana e inspektorëve këto problematika janë adresuar në detyra për zbatim në Vendimet Përfundimtare të mbajtura rast pas rasti si dhe janë marrë masa administrative kryesore Paralajmërim dhe Gjohë.

Gjithashtu në rastet e konstatimit të shkeljeve flagrante inspektori i punës vendos masën urgjente të pezullimit të punës, si dënim plotësues në përputhje me ligjin për inspektimin.

Tabela më poshtë pasqyron masat e marra nga inspektorati i punës gjatë kontrolleve të ushtruara për shkak ankese krahes detyrave të lëna për zbatim(në total pra jo vetëm për ankesa të denoncuara nga punëmarrëse femra)

<i>Pezullim/Masë urgjente për shkelje të marrëdhënieve të Punës</i>	<i>Pezullim/ masë urgjente për siguri në punë</i>	<i>Paralajmerim</i>	<i>Gjobë</i>	<i>Vlerë (.000)</i>
61	7	166	42	10,749

Duke ju falenderuar,

KRYEINSPEKTOR

Eljo Mucaj

